



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 15.07.2016

Ref.: 648/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditoohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “UBT” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (me specializime: Rrjeta dhe Telekomunikacion; Softuer dhe Sistemet Inxhinierie; Bazat e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit; Dizajn dhe Multimedia; Mekatronikë dhe Robotikë), (maksimum 760 student për vit akademik), Prishtinë dhe Ferizaj;
- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, MSc, 120 ECTS (me specializime: Rrjeta dhe Telekomunikacion; Softuer dhe Sistemet Inxhinierie; Bazat e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit; Dizajn dhe Multimedia; Mekatronikë dhe Robotikë), (maksimum 100 student për vit akademik);
- Menaxhimi i Mekatronikës, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Elektroteknika; Elektronika; Teknologjia e Informacionit; Prodhimtaria Industriale; Dizajni Industrial; Ndërmarrësi dhe Menaxhment; Robotika; Inxhinieri Biomjeksore; Mekatronika në Agrikulture), (maksimumi 130 student për vit akademik);
- Menaxhimi i Mekatronikës, MSc, 120 ECTS, (me specializime: Elektroteknika; Elektronika; Teknologjia e Informacionit; Prodhimtaria Industriale; Dizajni Industrial; Ndërmarrësi dhe Menaxhment), (maksimumi 50 student për vit akademik).

II. Riakreditoohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Projektim; Planifikim Urban dhe Hapsinor), (maksimum 500 student për vit akademik) Prishtinë dhe Ferizaj;
- Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, BSc, 180 ECTS, (maksimum 150 student për vit akademik);
- Media dhe Komunikim, BA, 180 ECTS, (maksimum 100 student për vit akademik);
- Shkenca Politike, BA 180 ECTS, (me specializime: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; Integritime Evropiane; Administratë Publike), (maksimumi 95 student për vit akademik).

III. Akreditohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, MSc, 120 ECTS (me specializime: Konstruktiv; Infrastrukturë), (maksimumi 70 student për vit akademik);
- Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik);
- Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, BSc, 180 ECTS, (maksimum 60 student për vit akademik);
- Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (me specializime: Dizajn Industrial; Dizajn i Produkteve; Dizajn Tekstili; Dizajn Interier; Dizajn Grafik), (maksimum 50 student për vit akademik);
- Infermieri, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik);

IV. Nuk akreditohen programet e studimit:

- Farmaci, MPh, 300 ECTS;
- Shkenca Politike, MA, 120 ECTS.

V. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji “UBT” për hapjen e degës në Prizren për këto programe të studimit:

- Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Projektim; Planifikim Urban dhe Hapsinor), (maksimum 150 student për vit akademik);
- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (me specializime: Rrjeta dhe Telekomunikacion; Softuer dhe Sistemet Inxhinierie; Bazat e të Dhënave

dhe Sistemet e Informacionit; Dizajn dhe Multimedia; Mekatronikë dhe Robotikë), (maksimum 150 student për vit akademik).

Kohëzgjatja e akreditimit të këtyre programeve të studimit në këtë degë është e njëjtë me kohëzgjatjen e akreditimit të programeve të ofruara në qendër.

- VI. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- VII. Obligohet BPrAL Kolegji “UBT” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- VIII. Obligohet BPrAL Kolegji “UBT” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

## A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “UBT” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	BSc	180	Muzafer Shala, Ardian Gojani, dhe Nebi Pllana
2	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	MSc	120	Edmond Hajrizi, Ylber Limani, dhe Bertan Karahoda
3	Menaxhimi i Mekatronikës	BSc	180	Lutfi Bina, Afrim Osmani dhe Nol Dedaj
4	Menaxhimi i Mekatronikës	MSc	120	Mihane Kerrolli, Sami Gashi, dhe Afete Musliu
5	Arkitekturë dhe Planifik Hapsinor	BSc	180	Ajhan Bajmak, Kujtim Elezi dhe Bujar Demjaha
6	Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë	BSc	180	Muhamet Ahmeti, Feti Selmani, dhe Visar Krelani
7	Media dhe Komunikim	BA	180	Ferid Selimi, Ilir Zylfiu, dhe Ruzhdi Matoshi
8	Shkenca Politike	BA	180	Ardian Emini, Besim Gallopeni, dhe Isak Sherifi

9	Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë	MSc	120	Hysen Ahmeti, Hazir Cadraku, dhe Asan Idrizi
10	Media dhe Komunikim	MA	120	Belul Beqaj, Gjylbehare Murati, dhe Nehat Ramadani
11	Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji	BSc	180	Gjavit Bytyqi, Nazmi Hasani dhe Sami Makolli
12	Dizajn i Integruar	BA	180	Binak Beqaj, Ponesta Dika, dhe Shpresa Suli
13	Infermieri	BSc	180	Sali Krasniqi, Besnik Elshani, dhe Avdyl Krasniqi
14	Farmacit	MPh	300	Shpend Dragusha, Naser Kamberi, dhe Festina Balidemaj
15	Shkenca Politike	MA	120	Abdullah Azizi, Selami Suli, dhe Metush Sulejmani

AKA ka organizuar dy vizita në BPrAL Kolegji "UBT". Vizita e parë është realizuar më 17.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Peeter Normak; Prof. Dr. Balint Bachman; Prof. Dr. Walter Cadek; Prof. Dr. Gabor Dombay; Prof. Stephen Adam; Mr. Tapio Heiskari. Vizita e dytë është realizuar më 10.06.2016 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Wolfgang Patsch; Prof. Dr. Reiner Doluschitz; Prof. Dr. Thomas Bauer.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "UBT", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Farmaci, MPh, 300 ECTS raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, duket se ka konfuzion për sa i përket strukturës së kurrikulës. Ekspertët kanë mësuar se ka dallime/ kontradikta të ndryshme në mes të strukturës së përgjithshme të kurrikulës dhe përshkrimeve të detajuara të lëndëve. Sipas ekspertëve titujt e lëndëve dallojnë nga mënyra se si janë paraqitur në kurrikulë dhe në përshkrimet e detajuara të lëndëve. Përderisa programi i studimit përmban shumë nga lëndët e nevojshme, disa tema të rëndësishme për këtë lloj të programit të studimit nuk janë paraqitur dhe mbuluar mjaftueshëm nga institucioni. Ekspertët kanë thënë se përderisa është e qartë se ky program i studimit do të ishte mjaft efektiv dhe përfitues për Kosovën,

për shkak të shumë të metave në aplikacionin aktual, të cilat duhet të përmirësohen para dhënies së akreditimit, ekspertët nuk mund të rekomandojnë akreditimin e programit.

Në lidhje me programin e studimit Shkenca Politike, MA, 120 ECTS raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, problemi kryesor është që struktura e programit është mjaft e pazakontë për një program Master. Për më tepër, pas një analize më të afërt ekspertët kanë vërejtur defekte serioze në këtë program të studimit. Sipas ekspertëve modulet ofrojnë një varg të gjerë të studimeve mirëpo nuk ka ndonjë modul i cili fokusohet kryesisht sipas kontekstit kosovar. Ekspertët kanë thënë se i gjithë programi nuk ka ndonjë dallueshmëri apo një element unik. Modulet e paraqitura në këtë program të studimit janë tejet tradicionale dhe konservative në natyrën e tyre. Këto module ofrojnë njësi të vogla të mësimi, të cilat nuk janë të përshtatshme për programe të studimit Master. Sipas ekspertëve, shumë nga modulet e paraqitura duken të jenë module hyrëse në natyrë mirëpo ato do të ishin më tepër të përshtatshme për programe të nivelit BA.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "UBT"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë